

LIGJ
Nr.9797, datë 23.7.2007

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8744, DATË 22.2.2001 “PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pas nenit 8 shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a

Revokimi i transferimit të pronësisë

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon pushtetin vendor, revokon transferimin e së drejtës së pronësisë kur:

- a) prona nuk i shërben më realizimit të funksioneve ose shërbimeve, të njohura me ligj nga njësitë e qeverisjes vendore;
- b) prona, që ka kaluar në pronësi të qeverisjes vendore, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5452, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi